



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT BASHKIAK SHKODËR DATË
20.07.2023

Me datë 20.07.2023, u mbajt mbledhja e këshillit bashkiak Shkodër. Këshilltarë të pranishëm ishin: Oltion Luli, Edmond Ndou, Uarda Gjekaj, Blediane Nika, Fatbardh Dama, Vjollca Petani, Armela Brahimi, Mirsad Bashi, Hedije Nasa, Ardit Taflaj, Alma Mehmetaj, Gezim Galiqi, Taulant Shahmani, Jurgena Bracaj, Florian Bjanku, Joniz Osmanagaj, Irena Shala, Artan Haxhi, Irma Kopliku, Valjeta Bajraktari, Ardit Behri, Eliona Shkrela, Gjergj Sokoli, Rezarte Pode, Jetmira Rraboshta, Ervin Brahimi, Violeta Perndrecaj, Gjovalin Ndoj, Ardita Spahija, Samed Bushati, Suada Kopshti, Erkan Hoxha, Marina Duhani, Blendi Gjylbegaj, Gloria Shllaku, Imeldi Sokoli, Muharrem Shkjau, Plarent Anamali

Mbledhja hapet nga Kryetari i Këshillit, z. Oltion Luli.

Rendi i ditës së mbledhjes është si vijon:

1. Pr/Vendim: *"Për përdorimin e fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike deri në 6% për muajin Prill 2023".*
2. Pr/Vendim: *"Për përdorimin e fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike deri në 6% për muajin Maj 2023".*
3. Pr/Vendim: *"Për përdorimin e fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike deri në 6% për muajin Qershor 2023".*
4. Pr/Vendim: *"Për miratimin e strukturës, numrit dhe anëtarëve të komisioneve të përhershme të këshillit bashkiak Shkodër"*
5. Pr/Vendim: *"Për deklarimin e mbarimit para kohe të mandatit të Këshilltarit Z. Rudin Beka"*
6. Pr/Vendim: *"Për miratimin e Pr/ Vendim: "Për miratimin e nivelit të pagave të funksionarëve të zgjedhur ose të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të Bashkisë Shkodër dhe institucioneve të varësisë"*
7. Pr/ Vendim: *"Për një ndryshim në VKB nr.71, datë 27.12.2023 "Për miratimin e buxhetit të vitit 2023 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2023-2025 të Bashkisë Shkodër, i ndryshuar"*

8. Pr/ Vendim: *"Për shtesë në buxhetin e vitit 2023 miratuar me VKB nr.71, datë 27.12.2023 "Për miratimin e buxhetit të vitit 2023 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2023-2025 të Bashkisë Shkodër, i ndryshuar"*
9. Pr/ Vendim *"Për krijimin e shoqërisë aksionare "Bio Strajca", SH.A, si person juridik në pronësi të bashkisë Shkodër, miratimin e aktit të themelimit dhe statutit.*
10. Pr/Vendim: *"Për miratimin e listës së kullotave të gatshme për kullotje dhe kositje bari"*
11. Pr/Vendim: *"Për dhënie pëlqimi për dhënie me qira të ekonomisë pyjore "Pruemos Sheldi", Njësia Administrative Gur i Zi, Fshati Sheldi, ngastra 104, për aktivitetin instalim të shtyllës erëmatëse për studimin e erës, aerogeneratorë, për një periudhë 18 muaj për shoqërinë "Ëind Stream sh.p.k"*
12. Pr/Vendim: *"Për dhënie pëlqimi për dhënie me qira të ekonomisë pyjore "Pruemos Sheldi", Njësia Administrative Gur i Zi, Fshati Sheldi, ngastra 104, për aktivitetin instalim të shtyllës erëmatëse për studimin e erës, aerogeneratorë, për një periudhë 12 muaj për shoqërinë "Vitalia Albanie"*
13. Diskutime jashtë rendit të ditës.

Kourumi i domosdoshëm është i pranishëm në sallë, mbledhja deklarohet e hapur.

Para se të vijohet me rendin e ditës Znj.Shkrela ka një kërkesë për mbajtjen e një minut heshtjeje në nderim të Z.Gjelosh Rushaj, i cili humbi jetën në rrugën e Dukagjinit. Sic të gjithë e dinë edhe kontributin që ai ka dhënë për këtë rrugë. Dhe shpresojmë që të vihet dorë njëherë e mirë në këtë rrugë.

Mbahet një minut heshtje në nderim të Z.Rushaj.

Përpara se të vijohet me hedhjen në votim të rendit të ditës, kryetari i Këshillit ka një kërkesë të Kryetarit të bashkisë për shtesë në Rendin e ditës të Pr.Vendimit: *"Për miratimin e kriterëve dhe procedurës të përzgjedhjes së anëtarëve të Këshillit Vendor të Rinisë, si dhe mënyrës së organizimit të funksionimit të tij në Bashkinë Shkodër"*

Z.Bjanku merr fjalën dhe shprehet se siç e dimë kjo mbledhje vjen pas mbledhjes së konstituimit të këtij këshilli të nderuar. Në këtë mbledhje është paraqitur një rend dite me shumë pika. Besoj se nga mbledhja e parë ka kaluar shumë kohë, duke sjellë që përtej miratimit të çështjeve të organizimit dhe funksionimit të këshillit, në këtë mbledhje na janë paraqitur për miratim shumë pika që me patjetër duhej të kalonin sipas ligjit të vetëqeverisjes vendore dhe rregullores së këshillit, paraprakisht në komisionet e përhershme. Kjo natyrisht që ka qënë e pamundur pasi komisionet e përhershme janë paraqitur për miratim po në këtë mbledhje. Dyshoj që koha e gjatë e kaluar nga mbledhja e parë është bërë pikërisht për të propozuar sa më tepër vendimmarrje, duke çfokusuar anëtarët dhe duke iu shmangur procedurës normale që kërkon që propozimet

për vendimmarrje të kalojnë së pari në komisione dhe natyrisht që përveç ekspertizës ofrojnë transparencë për publikun.

Rregullorja e bën shumë të qartë, citoj nenin 51 të saj:

"Si rregull fillimisht i jepet fjala propozuesit të projekt-aktit për të relatuar për propozimin. Pas relatimit të propozimit vijohet me relatimin e komisioneve që kanë shqyrtuar materialin. Pas relatimit të komisioneve vijohet me pyetje nga këshilltarët për propozuesin e projekt aktit".

Në këto kushte propozoj ndryshimin në rendin e ditës së kësaj mbledhje ku të kalojnë për miratim vetëm pikat që kanë të bëjnë me:

1. Projekt-vendimet që kanë të bëjnë me ndihmën ekonomike.

Në fakt ky miratim duhej bërë në një mbledhje shumë më të shpejtë, pasi, siç e kam ngritur si shqetesim me grupin dhe kryetarin e këshillit, të cilin e falenderoj për reagimin e shpejtë pas kërkesës time për thirrjen e mbledhjes, janë mbi 200 familje që kanë me shumë se dy muaj që nuk marrin këtë ndihmë që në fakt është për mbijetesë. Kjo gjë ndodh vetëm se nuk jemi mbledhur si KB për të miratuar formalisht lëmoshën që në fakt nuk është as nga buxheti i bashkisë, por është grant i kushtëzuar.

3.P/Vendimi: "Për deklarimin e mbarimit para kohe të mandatit të Këshilltarit Z.Rudin Beka"

Pr/ Vendim: "Për miratimin e strukturës, numrit dhe anëtarëve të komisioneve të përhershme të këshillit bashkiak Shkodër"

4. Pr/ Vendim: "Për miratimin e nivelit të pagave të funksionarëve të zgjedhur ose të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të Bashkisë Shkodër dhe institucioneve të varësisë"

5. Pr/ Vendime për ndryshime të buxhetit vetëm për sa i takon efekteve financiare të rritjes së pagave.

Sa i takon projekt-vendimit dhe relacionit të paraqitur për miratimin e niveleve të pagave në zbatim të VKM nr. 328 dt 31.05.23 "Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore",

Jemi në kushtet që mund ta kalojmë menjëherë, si në rastin e miratimit të ndihmës ekonomike, pasi bëhet fjalë për një zbatim të VKM dhe me efekte për trajtimin financiar të administratës të bashkisë.

Gjithsesi në këtë rast kërkoj që të zbatohet me korrektësi kjo VKM duke vendosur atë që vetë pikërisht, citoj pikën 15 të VKM-së:

"Efektet financiare, që mjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, fillojnë nga data 1 prill 2023 dhe për vitin 2023 përballohen:

a) për nivelet e pagave sipas kufint minimal, nga fondet e kontingjencës, të miratuara për vitin 2023;

b) për çdo nivel page të miratuar mbi kufirin minimal e deri në kufirin maksimal, nga të ardhurat e veta të njërive të vetëqeverisjes vendore"

Së fundmi, kërkoj që këto kërkesa, sipas rregullores, të përfshihen në procesverbalin e kësaj mbledhje.

Z.Luli mirëpret propozimet e Z.Bjanku dhe shprehet se kjo është mbledhja e dytë e këtij Këshilli dhe beson që koha ka qënë e pakët por ato cfarë u propozuan do hidhen në votim.

Hidhet në votim rendi i ditës së bashku me shtesën e propozuar nga Kryetari i Bashkisë, ku rezultojnë 36 vota Pro, 0 Kundër, 1 Abstenim.

Miratohet

1.Mbledhja vijon me tre Pr/Vendimet e para të rendit të ditës, të cilat meqënëse kanë të njëjtën përmbajtje do relatohen së bashku por votimi i tyre do kryhet ndarazi.

1. Pr/Vendim: *"Për përdorimin e fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike deri në 6% për muajin Prill 2023"*.
2. Pr/Vendim: *"Për përdorimin e fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike deri në 6% për muajin Maj 2023"*.
3. Pr/Vendim: *"Për përdorimin e fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike deri në 6% për muajin Qershor 2023"*.

Relaton nga administrata Z. Malocaj, drejtor i drejtorisë së Ndihmës Ekonomike, sipas materialit të përgatitur nga punonjësit e administratës.

Kalohet tek mendimet e kryetarëve të grupeve politike. Në emër të grupit të PS, Z.Ndou shprehet pro Pr.Vendimeve, në emër të grupit të PSD Z.Sokoli po ashtu shprehet dakort miratimit të Pr.vendimeve, edhe Znj.Shala për grupin BF dhe Z.Gjylbegaj për grupin PD shprehin dakortësi.

Hidhet në votim Pr/Vendim: *"Për përdorimin e fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike deri në 6% për muajin Prill 2023"* , ku rezultojnë 39 vota Pro, 0 Kundër, 0 Abstenim.

Miratohet

Hidhet në votim Pr/Vendim: "Për përdorimin e fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike deri në 6% për muajin Maj 2023", , ku rezultojnë 39 vota Pro, 0 Kundër, 0 Abstenim.

Miratohet

Hidhet në votim Pr/Vendim: "Për përdorimin e fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike deri në 6% për muajin Qershor 2023", ku rezultojnë 39 vota Pro, 0 Kundër, 0 Abstenim.

Miratohet

Vijohet me pikën 4. të rendit të ditës : Pr/Vendim: "Për miratimin e strukturës, numrit dhe anëtarëve të komisioneve të përherëshme të këshillit bashkiak Shkodër"

Relaton në cilësinë e Kryetarit të këshillit Z.Luli sipas relacionit të përgatitur. Pyetje dhe diskutime nuk ka. Kalohet në mendimit e kryetarëve të grupeve politike, të cilët shprehen dakort me miratimin e këtij Pr.vendimi.

Projekt akti hidhet në votim, ku rezultojnë 39 vota Pro, 0 Kundër, 0 Abstenim.

Miratohet

Vijohet me pikën 5. të rendit të ditës: Pr/Vendim: "Për deklarimin e mbarimit para kohe të mandatit të Këshilltarit Z.Rudin Beka"

Relaton në emër të komisionit të mandateve Znj.Gjekaj, sipas materialit të përgatitur. Kalohet në mendimit e kryetarëve të grupeve politike, të cilët shprehen dakort me miratimin e këtij Pr.vendimi.

Projekt akti hidhet në votim, ku rezultojnë 39 vota Pro, 0 Kundër, 0 Abstenim.

Miratohet

Kalohet në pikën 6. të rendit të ditës: Pr/Vendim: "Për miratimin e Pr/ Vendim: "Për miratimin e nivelit të pagave të funksionarëve të zgjedhur ose të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të Bashkisë Shkodër dhe institucioneve të varësisë"

Relaton Znj.Peraj, drejtoreshë e drejtorisë së Burimeve Njerëzore në Bashkinë Shkodër. sipas materialit të përgatitur nga administrata.

Fjalën e merr Z.Bjanku, i cili kërkon të dijë se kur i fillon efektet financiare ky vendim sepse VKM shprehet qartë për datën 1 prill 2023.

Znj.Peraj përgjigjet se VKM është taksative për zbatim dhe se llogaritja e saktë do bëhet pas daljes së strukturës dhe mbulimi financiar mund të kryhet pasi fondet janë.

Znj.Gjekaj shprehet që nuk është e nevojshme të citohet në Pr.vendim data e fillimit të efekteve financiare pasi VKM prevalojnë mbi VKB dhe sigurisht që data është 1 prill 2023.

Z.Anamali merr fjalën dhe mbështet kërkesën Z.Bjanku për të cituar datën e fillimit të përfitimit në Pr.Vendim që të mos ketë keqkuptime dhe kuptohet saktë që të gjithë përfituesit do marrin edhe pjesën e prapambetur.

Z.Gjylbegaj shprehet që niveli i pagave duhet të jetë edhe më i lartë duke parë standartet e jetesës dhe largimin e specialistëve.

Përsëri Znj.Gjekaj sqaron se rregullorja e Këshillit bashkiak shprehet qartë për çdo gjë lidhur me Pr.Vendimet dhe propozimet e ardhura në Këshill.

Z.Bjanku merr fjalën përsëri dhe kërkon edhe njëherë që duhet deomos që Pr.Vendimet të kalojnë tek komisionet përkatëse pastaj në mbledhje për vendimmarrje.

Projekt akti hidhet në votim, ku rezultojnë 39 vota Pro, 0 Kundër, 0 Abstenim.

Miratohet

Vijohet me pikën 7. të rendit: Pr/ Vendim: *“Për një ndryshim në VKB nr.71, datë 27.12.2023 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2023 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2023-2025 të Bashkisë Shkodër, i ndryshuar”*

Relaton për administratën Znj.Haxhi sipas materialit të përgatitur nga administrata.

Fjalën e kërkon Znj.Shkrela, e cila ka një pyetje në lidhje me strehëzën e qenëve. Ajo shprehet që në parim është dakort, por ajo do të dijë nëse ka një numër të saktë të qenve që ka në Shkodër dhe a e zgjidh kjo strehëz problemin e qenëve 100%? Gjithashtu ajo shton se duhet të gjendet një strategji e mirëmenduar për zgjidhjen e problemit përfundimisht.

Z.Alban Sekja nga administrata përgjigjet dhe shprehet se në Shkodër rezultojnë rreth 1000 qen kurse tek strehëza ndodhen rreth 100 qen dhe mendohet që në vazhdim aty të ketë minimalisht 300 dhe kjo e zgjidh problemin pothuajse përfundimisht. Po punohet edhe me Bashkitë e tjera që të stopohen prurjet e qenëve në territorin e Shkodër.

Z.Bashi gjen rastin të përgëzojë Bashkinë e Shkodrës për ndërtimin e strehëzës dhe shprehet dakort për këtë iniciativë.

Z.Anamali merr fjalën dhe kërkon të dijë përveç fondit të ndërtimit të strehëzes a është menduar edhe për mbajtjen e këtyre qenëve, ushqim, përkujdesje etj?

Z.Galiqi po ashtu kërkon të dijë përse Bashkia Shkodër nuk e ka realizuar parashikimet e saj 100%, ku ka patur problem?

Znj.Haxhi përgjigjet që arsyeja e mosrealizimit 100% është taksa e tokës bujqësore, problem ky në lidhje me pronësinë.

Z.Sokoli gjykon të drejtë që ky Pr.Vendim të ndahet në dy Vendime. Së pari mosrealizimi dhe dy shtesa. Ai mendon që të ketë një justifikim me të saktë të financimit.

Fjalën e merr Kryetari i bashkisë, i cili thekson faktin e nevojës për ndërhyrje në rrjetin e rrugëve me bicikleta. Si fillim do fillohet me shumë pak lek, me forcat e bashkisë, kurse përta i përket problemit të qenëve mendojmë që jemi në rrugën e duhur për një zgjidhje përfundimtare.

Z.Gjylbegaj shprehet se përgëzojnë të dyja nismat, si atë të qenve ashtu edhe për nismën e rrugës për bicikleta duke i parë si të rëndësishme të dy problematikat.

Z.Anamali mendon që duhet të mendohet edhe për vendqëndrimet e bicikletave, të cilat duhet të jenë më të shpeshta.

Kryetari i bashkisë Z.Beci sqaron që nuk u përmend në fakt pjesa e vendqëndrimit të bicikletave por është duke u punuar për ta, duke siguruar fonde nga donatorët.

Kalohet tek mendimi i kryetarëve të grupeve, të cilët shprehen dakort me Pr.Vendimin. Projekt akti hidhet në votim, ku rezultojnë 39 vota Pro, 0 Kundër, 0 Abstenim.

Miratohet

Vijohet me pikën 8. të rendit të ditës: Pr/ Vendim: *"Për shtesë në buxhetin e vitit 2023 miratuar me VKB nr.71, datë 27.12.2023 "Për miratimin e buxhetit të vitit 2023 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2023-2025 të Bashkisë Shkodër, i ndryshuar"*

Relaton për administratën Z.Luleta, drejtor drejtorisë së Shërbimeve Publike, sipas materialit të përgatitur.

Përsëri Znj.Shkrela merr fjalën dhe shpreh shqetësimin në lidhje me rasti e djegjes së shtëpisë së familjes Haxhija. Ajo kërkon të dijë pse premtimi i kryetarit nuk është mbajtur, sigurisht që ndihma e menjëhershme është dhënë.

Z.Luleta sqaron se familja në fjalë nuk ka bërë aplikim në kohë, por me porosi të kryetarit janë kontaktuar dhe është bërë aplikimi dhe beson që Brenda javës do përfundohet dokumentacioni dhe familja do përfitojë edhe ndihmën financiare që I takon.

Z.Beci merr fjalën dhe sqaron se kemi edhe rastin e një familjeje tjetër, rast ky që në mënyrë mediatike krijojë keqkuptime por pas hulumtimeve të bëra, u pa që nuk ishte rast Brenda këtij mandate, por kryetari i mëparshëm nuk i kishte dhënë zgjidhje, duke I refuzuar ndihmën financiare për arsye procedurale rastit në fjalë. Në mësim të kësaj dhe në respekt të familjeve në nevojë, ne do ndihmojmë të gjitha familjet që "ju" i keni thënë Jo.

Z. Luleta saktëson që aplikimi ka ardhur i vonuar prandaj dhe ndihma nuk është dhënë në kohë.

Znj.Petani merr fjalën dhe shprehet se gabimet e kryetarëve të tjerë në kaluarën nuk mund t'ia kalojmë kryetarit të ri. Ajo shton se ato as nuk kanë qënë present në sallë për të tilla raste minimalisht.

Znj.Shkrela kërkon të replikojë, por kryetari këshillit Z.Luli I tërheq vëmendjen për të disatën herë për të ruajtur etikën.

Z.Sokoli merr fjalën dhe shprehet se 4% e buxhetit vjetor të bashkisë vjen nga Ministria e Financës si transfertë e kushtëzuar për parandalimin dhe problemet me fatkeqësi të tilla. Ai kërkon të dijë sa % është e absorbuar nga Bashkia Shkodër? Dhe së dyti çfarë do të thotë vendosje në dispozicion e mjeteve teknologjike, marrje me qira apo blerje e këtyre mjeteve.

Z.Luleta përgjigjet se ky është fondi i parë që vjen për këtë vit dhe nuk mund të dalim me % për vazhdimësi, kurse për pyetjen e dytë Bashkia nuk i disponon të tilla mjeta prandaj ato merren me qira në raste nevojë.

Z.Beci merr përsëri fjalën dhe sqaron se kësaj rradhe u përdor modeli standart sepse nuk kishte kohë për të bërë një analizë të detajuar se çfarë na intereson në financiarisht por u ra dakort që të përdoret eksperiencia më e mirë gjatë këtyre viteve. Më vonë sigurisht që do rishikohet dhe do shihet mundësia më e mirë.

Z.Sokoli shprehet se duhet bërë sqarime, që ky 4% duhet detyruesisht të përdoret deri në fund të vitit sepse në të kundërt ai humbet, prandaj duhet të mendohet të përdoret për parandime dhe projektë në mënyrë që të absorbohet krejtësisht nga bashkia.

Z.Galiqi ka një pyetje për Z.Luleten, se mbi ç'bazë bëhet ndarja e këtij fondi?

Z.Luleta përgjigjet, që ky fond është i përdorshëm vetëm brenda vitit dhe nuk mund të trashëgohet dhe mund të përdoret vetëm për shërbime dhe mallra dhe jo për investime, prandaj dhe nuk mund të blihen mjete sepse quhet investim. Saktësisht nuk mund të flasim asnjëherë sepse ka fenomene natyrore që nuk mund të parashikohen.

Znj.Haxhi sqaron edhe njëherë që fondi i kushtëzuar vjen i mirëpërcaktuar nga Ministria.

Kalohet tek mendimi i kryetarëve të grupeve, të cilët shprehen dakort me Pr.Vendimin. Projekt akti hidhet në votim, ku rezultojnë 39 vota Pro, 0 Kundër, 0 Abstenim.

Miratohet

Z.Shkjau merr fjalën dhe kërkon që edhe ato si përfaqësues të subjekteve të vogla politike duhet të pyeten por Z.Luli sqaron se rregullorja e Këshillit Bashkiak nuk lejon krijimin e një grupi me jo më pak se 5 anëtarë.

Vijohet me pikën 9. të rendit të ditës: *“Për krijimin e shoqërisë aksionare “Bio Strajca”, SH.A, si person juridik në pronësi të bashkisë Shkodër, miratimin e aktit të themelimit dhe statutit.*

Relaton për administratën Z.Mema, drejtor drejtorisë së Shërbimeve Publike, sipas materialit të përgatitur.

Z.Bjanku kërkon të dijë se kush merr pjesë tek asambleja dhe bordi i administratës i shoqërisë në fjalë, kush janë anëtarët e bordit dhe nga kush përzgjidhen dhe së dyti, kur është bërë ndërhyrja e fundit tek Merkatoja Rus.

Z.Mema përgjigjet që tek asambleja e përgjithshme merr pjesë Kryetari i bashkisë, i cili drejton dhe e menaxhon atë.

Për sqarime më të detajuara fjalën e merr drejtoresha juridike në Bashkinë Shkodër Znj.Mjeda, e cila shprehet se tek statuti i shoqërisë është e shprehur krejt qartë pjesa e anëtarëve dhe administrimit duke qënë edhe shoqeri me një nivel dhe 100% e bashkisë si ortak i vetëm. Ligji përcakton qartë të dy organet e kësaj shoqërie.

- Z.Beci përgjigjet që ndërhyrja e fundit është bërë në 2017 dhe sot trgu është në gjëndje të amortizuar dhe mendon që duhet ndërhyrë sa më shpejt.

Z.Gjylbegaj thotë se e njeh mirë si procedurë dhe përgëzon nismën e një sh.a-je sepse kështu po merr rrugë një nisëm për tregjet dhe sepse një sh.a e ka më të lehtë të tërheq fonde.

Z. Gj.Sokoli shprehet se gjatë këtyre viteve është premtuar shumë për atë treg prandaj vlerësojmë shumë nismën,

Z.I.Sokoli dëshiron të thotë së pari se mirëpret nismën por ai kërkon të dijë në se ka një plan biznesi për këtë shoqëri aksionere? Si do jetë organigrama e saj?

Znj.Mjeda sqaron që kjo është vetëm faza e parë. Në fazën e dytë do paraqitemi në Keshillin bashkiak në lidhje me detajet e kësaj sh.a-je në paketën fiskale.

Kalohet tek mendimi i kryetarëve të grupeve, të cilët shprehen dakort me Pr.Vendimin. Znj.Shala, në emër të grupit Bf shprehet se janë dakort në parim me projektin por abstenojnë për shkak të procedurës. Projekt akti hidhet në votim, ku rezultojnë 30 vota Pro, 0 Kundër, 9 Abstenim.

Miratohet

Kalohet në pikën e radhës: Pr/Vendim: *“Për miratimin e listës së kullotave të gatshme për kullotje dhe kositje bari”*

Relaton nga ana e Bashkisë Z.Ndoci, sipas materialit të përgatitur nga administrata.

Kalohet tek mendimi i kryetarëve të grupeve, Z.Ndou për PS, Z.Sokoli për PSD dhe Z.Gjylbegaj për PD, të cilët shprehen dakort me Pr.Vendimin. Përsëri Znj.Shala, për grupin Bf abstenojnë për shkak të procedurës. Projekt akti hidhet në votim, ku rezultojnë 30 vota Pro, 0 Kundër, 9 Abstenim.

Miratohet

Vijohet në pikën e radhës: Pr/Vendim: *“Për dhënie pëlqimi për dhënie me qira të ekonomisë pyjore “Pruemos Sheldi”, Njësia Administrative Gur i Zi, Fshati Sheldi, ngastra 104, për aktivitetin instalim të shtyllës erëmatëse për studimin e erës, aerogjeneratorë, për një periudhë 18 muaj për shoqërinë “Ëind Stream sh.p.k”*

Dhe Pr/Vendim: *“Për dhënie pëlqimi për dhënie me qira të ekonomisë pyjore “Pruemos Sheldi”, Njësia Administrative Gur i Zi, Fshati Sheldi, ngastra 104, për aktivitetin instalim të shtyllës erëmatëse për studimin e erës, aerogjeneratorë, për një periudhë 12 muaj për shoqërinë “Volitalia Albanie”*

Meqënëse këto dy Pr.Vendime kanë të njëjtën përmbajtje relatohen së bashku nga Z.Ndoci, por votohet ndarazi.

Z.Galiqi kërkon të dijë se për ç'arsye këto kompani kërkojnë të bëjnë këto studime?

Z.Ndoci përgjigjet se këto kompani kanë zgjedhur fshatin Sheldi, si zonë me potencial për kryerjen e të tilla studimeve në lidhje me matjen e erës.

Z.Anamali shprehet se vëren se në relacion mungon statusi juridik i pronës në fjalë. Së dyti materisli nuk paraqet një raport tekniko-ekonomik.

Z.Ndoci, sqaron në lidhje me pyetjen e parë se këto prona janë të parinovuara në sistemin e ASHK-së prandaj dhe nuk mund të dalin me një përgjigje.Këto prona nuk janë të certifikuara si pronë e bashkisë por të kaluara me VKM.

Z.Galiqi përsëri shprehet se të tilla kompani që ofrohen për studime duhet të njihen më detajisht që edhe ne të jemi të qartë se kujt po ia japim pronën me qira.Ai mendon se relacioni duhet të ishte më i detajuar.

Z.Beci Sqaron se komponentë janë shumë serioze dhe qëllimi i bashkisë Shkodër të avantazhojë cdo iniciativë të energjisë energjitike të rinovueshme brenda të gjith kushteve dhe kritereve. Gjithsesi hapat e tjerë do paraqiten në Këshillin bashkiak.

Z Sokoli shprehet se duhet të jemi të qartë në vijë mësi se ç'përfitime do ketë Bashkia Shkodër nga këto nisma.

Kurse Znj.Gjekaj kërkon që të korrigjohet baza ligjore tek këto dy Pr.Vendime.

Z.Gjylbegaj vlerëson dhe mendon që duhen mirëpritur kompani të tilla, sepse përfitimet për Bashkinë janë të mira nga taksat dhe nga vendet e reja të punës që hapin.

Z.Bjanku propozon që të tilla studime si në Sheldi të mund të kryhet edhe në qytet sepse kemi mjaft hapësira të shfrytëzueshme.

Kalohet tek mendimi i kryetarëve të grupeve,Z.Ndou për PS, Z.Sokoli për PSD dhe Z.Gjylbegaj për PD, të cilët shprehen dakort me Pr.Vendimin. Përsëri Znj.Shala, për grupin Bf abstenojnë për shkak të procedurës.

Projekt akti i parë hidhet në votim, ku rezultojnë 28 vota Pro, 0 Kundër, 11 Abstenim.

Miratohet

Projekt akti i dytë hidhet në votim, ku rezultojnë 29 vota Pro, 0 Kundër, 10 Abstenim.

Miratohet

Kalohet tek pika shtesë e rendit të ditës: Pr.Vendimit: *"Për miratimin e kritereve dhe procedurës të përzgjedhjes së anëtarëve të Këshillit Vendor të Rinisë, si dhe mënyrës së organizimit të funksionimit të tij në Bashkinë Shkodër"*

Relaton nga ana e Bashkisë Znj.Kraja, sipas materialit të përgatitur nga administrata.

Kalohet tek mendimi i kryetarëve të grupeve, të cilët shprehen dakort me Pr.Vendimin. Projekt akti hidhet në votim, ku rezultojnë 39 vota Pro, 0 Kundër, 0 Abstenim.

Miratohet

Kalohet në diskutime jashtë rendit të ditës.

Fjalën e merr Z.Anamali i cili shprehet në lidhje me vendim e Kryetarit të bashkisë për sinjalistikën rrugore, ai thotë që ka patur shumë ankesa nga komuniteti i banorëve dhe nga bizneset në këto zona. Vendimi sipas tij është marr në shkelje të kodit rrugor.Ai është vendim kolegial dhe jo individual dhe duhet të ishte marr sipas planit të mobilitetit. Tjetër shqetësim është edhe ndërtimi, projektimi sa më shpejt të jetë e mundur i ujrave të zeza, shumë i nevojshëm dhe emergjent për Shkodrën.

Z.Beci sqron në lidhje me problemin e ujrave të zeza se ai është një projekt i KfV-së, i cili ka filluar para ca kohësh por ka dal një problem i paparashikuar dhe është kërkuar të shtohet një shumë relativisht e madhe fondesh, e cila e bën shumë të shtrenjtë projektin. Është diskutuar me bankën gjermane dhe kemi lajme të mira dhe projekti është në proces.

Kurse përse i përket emergjencës për rregullimin e trafikut, mund të jetë e diskutueshme ana ligjore e saj por nga konsulenca që kam patur mund të ketë raste të vecanta që lejohet që Kryetari të marr vendime të përkohëshme për raste të tilla të trafikut të rënduar tek hyrja e Shkodrës. Sigurisht që shumë shpejt do ketë një plan të mirëstudiuar mobiliteti.

Për më tepër stafi i bashkisë do mbajë shënim cdo ankesë, rekomandim,sygjerim me qëllim që të punojmë si ekip në të mirë të qytetit dhe komunitetit.

Z.Pashuku ngre një shqetësim në lidhje me ndricimin tek zona e tij e banimit sepse ka shuë lëvizje he ka rezikshmëri të lartë aksidentesh.

Znj.Pode merr fjalën dhe ngre dy shqetësime, së pari në lidhje infrastrukturën e amortizuar të pallateve dhe së dyti propozon vendosjen e administratorëve të pallateve, në mënyrë që problematikat të adresoheshin specifikisht dhe dikush të mbante përgjegjësi.

Z.Beci i sheh shumë të drejta shqetësimet e paraqitura dhe thotë që i ka kërkuar administratës që të marrë ca shëmbuj të mirë të qyteteve të tjera, ku mund të merret e baza ligjore dhe kjo të aplikohet edhe për Shkodrën.

Problemi i amortizimit të pallateve është në proces dhe po shihet nga një grup pune. Është ndërhyrë në raste emergjente por problemi është më i madh se kaq. Shpejt do nderhyhet tek fasadat e pallateve deri në shterimin e problematikës.

Z.Behri merr fjalën dhe thotë se nisur nga fluksi i turistëve në Velipojë mendon që është e domozdoshme të pastrohet pjesa e shatërvanit dhe pjesës rreth tij.

Z.Beci shprehet se dy ditë më parë i është kërkuar punonjësve të pastrimit të pastrojnë shatërvanin dhe krejt zonën e shëtitores.Është në proces.

Znj.Shala shpreh shqetësimin e saj në lidhje me Velipojën , si një pikë kryesore e gjenerimit të të ardhura për bashkinë Shkodër. Ajo propozon afishimin e hartave të plazheve publike dhe largimin e inerteve që janë në bregdet.

Z.Beci thotë se patjetër që cdo gjë për Velipojën është në proces.Është diskutuar edhe për hartat dhe shumë shpejt do ketë një ndërhyrje miqësore për lirim të hapësirave publike aty.

Znj.Nika merr fjalën dhe thotë që hartat nuk kanë pësuar ndryshim. Komisioni ka paraqitur ankesa dhe ka lënë mjaft rekomandime shumë herë, si pasojë e problematikave lidhur me hapësirat publike. Duhet parë sa janë zbatuar këto rekomandime dhe ai mendon që përmirësimi është i dukshëm.

Z.Beci shprehet që ky është vetëm fillimi me punën që duhet bërë në Velipojë.Mirpres cdo shqetësim dhe rekomandim të ardhur nga ju.

Z.Shkjau kërkon ndërhyrje në infrastrukturën e lagjes “Draçin” dhe ai mendon se duhet parë me prioritet.

Z.Sokoli shpreh dy shqetësime 1. Në lidhje me rrugën e Dukagjinit dhe 2. Në lidhje me qendrën shëndetësore tek ish-konvikti”S.Spahiu”. Ajo qëndër është jashtë cdo standarti dhe në gjendje të mjerueshme.

Z.Beci sqaron se me rrugën e Dukagjinit po punohet fort dhe shumë shpejt do kemi lajme të mira.Po ashtu edhe për qendrën shëndetësore do shihet me prioritet. Cdo gjë do mbahet shënim nga stafi që të bëhet më e mira.

Z.Gjylbegaj kërkon të dijë në lidhje me problemin e taksave të UKSH-së edhe pse ai shprehet që kërkesat e anëtarëve të këshillit mund të paraqiten edhe me e-mail,që specialistët e administratës të kenë mundësi të përgjigjen saktësisht edhe për detaje teknike.

Znj.Haxhi sqaron se UKSH-ja është bllokuar nga llogari të treta sepse kjo shoqëri nuk ka bërë derdhje detyrimesh karshi Bashkisë Shkodër.

Z.Gjylbegaj shpreh edhe një shqetësim të dyte lidhur me oborret e shkollave.Ai propozon që ato të përdoren mbasditeve për aktivitete dhe kënde lojrash për fëmijët e zonave përreth.Përgjigjen thotë ai mund ta diskutojmë edhe në mbledhjet e ardhshme.

Procesverbali, pasqyron në mënyrë të përmbledhur diskutimet e mbledhjes së këshillit bashkiak Shkodër të dates 20.07.2023. Bashkëlidhur këtij procesverbali, materiali i mbledhjes Audio.(DVD).

Procesverbali përmban 13 faqe dhe pasi lexohet, nënshkruhet pa vërejtje nga:

Sekretar

Denis LESH



KRYETAR

Oltion LULI

